



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201700864/5

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2017

**Lënda:** Rekomandohet "Marrja e masave të menjëhershme për ekzaminim mjekësor dhe psikiatrik të dënuarit A. V. A., dhe dërgimin e tij nga IEVPenale Fier, në Institucionin e Veçantë Shëndetësor të Burgjeve Tiranë"

**Drejtuar :** Z.Arben ÇUKO  
Drejtor

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE**

**TIRANË**

*I nderuar Z.ÇUKO,*

Më datë 17.07.2017, shtetasja greke A. P., me banim në qytetin e Tiranës, i është drejtuar me ankesë Institucionit të Avokatit të Popullit në të cilën ka ngritur pretendimin se, ndaj bashkëshortit të saj A. A., është ushtruar dhunë fizike dhe psikoklogjike nga ana e punonjësve të Policisë së Shtetit Tiranë, dhe të Burgjeve në IEVPenale Fier, ku ai është duke vuajtur dënimin.

Sipas ankueses znj. P., më datë 12.07.2017, kur është takuar me bashkëshortin në IEVPenale Fier, e ka parë në gjëndje shumë te keqe psikologjikisht i cili ishte shprehur se, ishte kërcënuar për jetën e tij dhe të familjes nga persona të panjohur në atë institucion.

Pra, znj. P., ka ngritur shqetësimin se bashkëshorti i saj A. A., keqtrajtohet me anë të dhunës fizike dhe psikologjike, dhe se mbahet në ambientet e spitalit të atij institucioni pasi gjëndjë shëndetësore nuk është ë mirë.

Mbi këtë shqetësim Avokati i Popullit ka urdhëruar kryerjen e një hetimi të pavarur administrativ, i cili ka konsistuar dhe në shkuarjen në vend, në IEVPenale Fier të Ndhmëskomisionerit të Avokatit të Popullit.

Në këtë institucion janë marrë deklaramë të dënuarit A. A., në dhomën e Qendrës Spitalore si dhe janë administruar dokumente të ndryshme me interes për çështjen, dosja personale, proces verbal i mbajtur nga komisioni pritës etj.

Në kuadër të hetimit janë kryer veprime në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, dhe më pas është kontaktuar me drejtorin dhe specialistin e SHKB-së së Burgjeve, pasi rasti është

hetuar nga ajo drejtori. Në përfundim të hetimit dhe konkretisht më datë 25.08.2017, znj. A.P., është informuar për veprimet e kryera dhe konstatimet nga hetimi i pavarur administrativ.

Më datë 10.09.2017, znj. P., me anë të email-it drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit (bashkëlidhur informacioni) informon për gjëndjen e rëndë shëndetësore nga mosushqyerja për disa ditë dhe ka pretenduar për dhunë psikologjike të bashkëshortit të saj A. A., duke kërkuar ndërprerjen e kësaj gjëndje dhe vizitë nga mjeku specialist.

Ju bëjmë me dije faktin se në momentin që Ndihmëskomisioneri i Avokatit të Popullit ka kontaktuar me të dënuarin A. A., më datë 17.07.2017, gjëndja e tij psikologjike ishte e rënduar, çka vështirësoi dhe komunikimin me të.

Në aktet ligjore dhe nënligjore që normojnë funksionimin e veprimtarisë së punës së Policisë të Burgjeve, flitet qartë për detyrimin që kanë IEVP-të për trajtimin e rasteve kur të dënuarit paraqiten me probleme shëndetësore apo çrregullime mendore, dhe si të tilla mund të përmëndimin;

Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve e miratuar me VKM nr.96, datë 09.03.2000, e ndryshuar, në nenin 30 të saj i cili bën fjalë për Shërbimin Shëndetësor shprehet në mënyrë të qartë se: *“Shërbimi shëndetësor duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë të të dënuarve që lidhet me shëndetin e tyre dhe në mënyrë periodike duhet të ushtrojë kontrolle mjekësore për të parë gjëndjen e përgjithshme të të dënuarve dhe veçanërisht atë psihike”*.

Në nenin 5 të ligjit nr.8328 datë 16.04.1998 “Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve dhe të Paraburgosurve” i ndryshuar, i cili bën fjalë për Parimet Themelore, thuhet: *“Të paraburgosurit dhe të dënuarit trajtohen me dinjitet dhe duke respektuar të drejtat njerëzore të tyre”*.

Kurse në nenin 33 të ligjit të mësipërm, i ndryshuar me ligjin nr.40/2014 datë 17.04.2014 i cili bën fjalë për Shërbimin Mjekësor, thuhet: *“Shërbimi mjekësor sigurohet gjatë gjithë kohës së qëndrimit në institucion nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe mbulohet nga sigurimi i detyrueshëm i kujdesit shëndetësor, sipas skemës në fuqi. Personat e paraburgosur dhe të dënuarit me burgim përfshihen në kategoria të personave ekonomikisht joaktivë, në kuptim të ligjit në fuqi, dhe përfitojnë, pa pagesë, të gjitha shërbimet që ofron skema e sigurimit shëndetësor sipas këtij ligji”*.

Të drejtat e të dënuarve për trajtim në shërbimin shëndetësor parashikohen dhe në aktet ndërkombëtare. Kështu, në Rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Jashtëm të Këshillit të Europës datë 12 Shkurt 1987 “Për Rregullat Europiane të Burgut”, ku në kapitullin që bën fjalë për Drejtimin e Sistemit të Burgjeve, në pikën 29 thuhet: *“Mjeku do të vizitojë dhe ekzaminojë secilin të burgosur menjëherë pas pranimit dhe më vonë sa herë të jetë e nevojshme, në mënyrë të veçantë për të zbuluar sëmundje fizike ose mendore dhe për të marrë të gjitha masat e nevojshme për trajtim mjekësor...”* kurse në Pikën 30.1 thuhet: *“Mjeku do të kujdeset për shëndetin fizik dhe mendor të burgosurve dhe në përputhje me kushtet e intervalet e standarteve spitalore, do të vizitojë të gjithë të burgosurit e sëmurë, të gjithë ata që raportojnë për sëmundje, ose dëmtim dhe çdo të burgosuri t’i kushtohet një vëmëndje e veçantë”*.

Në Pikën 32 të Rekomandimeve të mësipërme thuhet: *“Shërbimet mjekësore të institucionit do të kërkojnë që të diagnostikojnë e kurojnë çdo sëmundje ose të metë fizike e mendore, që mund të pengojë riintegrimin e një të burgosuri pas lirimit. Për këtë qëllim,*

*të burgosurit do t'i sigurohen të gjitha shërbimet e nevojshme mjekësore, kirurgjikale dhe psikiatrike, përfshirë ato që janë në dispozicion të komunitetit”.*

Shqetësimi i shtetases A. P., për gjëndjen jo të mirë shëndetësore dhe mendore e të dënuarit A. A., na duket i drejtë dhe si i tillë duhet të vlerësohet nga ana e juaj, me qëllim që në mundësitë e paraqitura të merren masat për kryerjen e ekzaminimit mjekësor e psikiatrik të të tij sa më parë në një insitucion të specializuar siç është dhe IVSHB-ve Tiranë.

Nga ana tjetër do të sugjerohet që personeli mjekësor i Shërbimit Shëndetësor në IEVPenale të vëndit duhet të verifikojnë dhe evidentojnë raste të tjera të mundshme të kërkesave të dënuarve që paraqiten me probleme të ndryshme të shëndetit, apo çrregullime mendore. me shqetësimet e të cilëve duhet të informohet drejtorja e institucionit dhe këto të fundit Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, për të marrë masat e nevojshme për këtë qëllim.

Për sa sipër duke gjetur se ankesa e shtetases A. P., lidhur me shqetësimet e bashkëshrotit të saj të dënuarit A. A., është e drejtë, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë ku thuhet: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të drejtave të njeriut nga administrate publike”* dhe në bazë të nenit 21 gërma “b” të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999, *“Për Avokatin e Popullit”* me ndryshimet përkatëse ku thuhet: *“Avokati i Popullit pas përfundimit të hetimit, paraqet rekomandime për vënien në vënd të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

## **REKOMANDOHET**

*“Marrja e masave të menjëhershme për ekzaminim mjekësor dhe psikiatrik e të dënuarit A. A., dhe dërgimin e tij nga IEVPenale Fier në Institucionin e Veçantë Shëndetësor të Burgjeve Tiranë.*

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij Rekomandimi, lutemi na njoftoni brënda afatit ligjor prej 30 ditë, e parashikuar në nenin 22 të ligjit *“Për Avokatin e Popullit”*.

*Duke besuar në mirëkuptimin Tuaj.*

**K O M I S I O N E R I**

Konc.&Dakt.P.A.  
Tiranë më 11.09.2017

**Arben SHKËMBI**